

LIGJ
Nr. 45/2025

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM
DHE ZHVILLIM PËR FINANCIMIN SHITESË PËR “VEPRIMIN E OFRIMIT
TË SHËRBIMEVE TË PËRQENDRUARA DHE GJITHËPËRFSHIRËSE
TË PËRDORUESIT”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, shkronja “ç”, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin shtesë për “Veprimin e ofrimit të shërbimeve të përqendruara dhe gjithëpërfshirëse të përdoruesit” sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 26.6.2025.

**Shpallur me dekretin nr. 214, datë 4.7.2025, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj.**

NUMRI I HUAS 97780-AL

MARRËVESHJE HUAJE

(Financim shtesë për veprimin e ofrimit të shërbimeve të përqendruara dhe gjithëpërfshirëse të përdoruesit)
**NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM**

Marrëveshje më datë datën e nënshkrimit, ndërmjet **Republikës së Shqipërisë** (“Huamarrësi”) dhe **Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim** (“Banka”) për qëllimin e ofrimit të financimit shtesë për Veprimin Fillestar të përshkruar në skedulin 1 të kësaj Marrëveshjeje (“Veprimi”).

Me anë të së cilës, Huamarrësi dhe Banka bien dakord si më poshtë:

Neni I

Kushtet e përgjithshme; përkufizimet

1.01 Kushtet e përgjithshme (siç përkufizohen në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje) zbatohen dhe përbëjnë pjesë të Marrëveshjes.

1.02 Përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, termat me shkronjë të madhe të përdorura në këtë Marrëveshje kanë kuptimet që u janë dhënë atyre në kushtet e përgjithshme ose në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje.

Neni II

Huaja

2.01 Banka bie dakord t'i japë hua Huamarrësit në shumën shtatëdhjetë e gjashtë milionë e nëntëqind mijë euro (76,900,000), ku një shumë e tillë mund të konvertohet herë pas here nëpërmjet këmbimit valutor ("Huaja), për të ndihmuar në financimin e:

a) programit, siç përshkruhet në pjesën 1 ("Programi") të skedulit 1 të kësaj Marrëveshjeje; dhe

b) projektit, siç përshkruhet në pjesën 2 ("Projekti") të skedulit 1 të kësaj Marrëveshjeje.

(Programi dhe Projekti në vijim, bashkërisht të referuar si "Veprimi").

2.02 Huamarrësi mund të tërheqë të ardhurat e Huas në përputhje me seksionin IV të skedulit 2 të kësaj Marrëveshjeje. Të gjitha tërheqjet nga llogaria e Huas, sipas Programit, do të depozitohen nga Banka në një llogari të specifikuar nga Huamarrësi dhe të pranueshme për Bankën.

2.03 Tarifa paraprake është një e katërta e një për qind (0.25%) të shumës së Huas.

2.04 Detyrimi i angazhimit është një e katërta e një për qind (0.25%) në vit mbi bilancin e patërhequr të Huas.

2.05 Norma e interesit është norma e referencës plus diferencën e ndryshueshme ose një normë të tillë, siç mund të zbatohet në vijim të një konvertimi; sipas seksionit 3.02(e) të kushteve të përgjithshme.

2.06 Datat e pagesës janë 1 mars dhe 1 shtator të çdo viti.

2.07 Shuma e principalit të Huas paguhet në përputhje me skedulit 3 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni III

Veprimi

3.01 Huamarrësi deklaron angazhimin e tij ndaj objektivave të Veprimit. Në këtë drejtim, Huamarrësi merr masa që Veprimi të zbatohet nga AKSHI në përputhje me dispozitat e nenit V të kushteve të përgjithshme dhe skedulit 2 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni IV

Mjetet ligjore të bankës

4.01 Rastet shtesë të pezullimit janë si vijon, specifikisht që legjislacioni i AKSHI-it të jetë ndryshuar, pezulluar, shfuqizuar, anuluar ose hequr dorë në atë mënyrë që ndikon materialisht dhe negativisht në aftësinë e Huamarrësit dhe AKSHI-it që të përmbushin detyrimet e tyre sipas kësaj Marrëveshjeje.

4.02 Rasti shtesë i përshpejtimit konsiston nga sa vijon, specifikisht që çdo rast i specifikuar në seksionin 4.01 të kësaj Marrëveshjeje ndodh dhe vijon për një periudhë 60 (gjashtëdhjetë) ditë pasi njoftimi i rastit i është dhënë Huamarrësit nga Banka.

Neni V

Hyrja në fuqi; ndërprerja

5.01 Kushtet shtesë të hyrjes në fuqi janë si vijon:

a) Huamarrësi ka përditësuar, nëpërmjet AKSHI-t, përbërjen dhe termat e referencës së Njesisë së Koordinimit për të përfshirë përfaqësues të MF-së, MSHPV-së, Agjencisë për Vetëqeverisjen Vendore, APP-së dhe KPP-së; dhe

b) Huamarrësi ka përditësuar dhe lidhur, nëpërmjet AKSHI-t, Memorandumin e Mirëkuptimit me MF, MSHPV-në, Agjencinë e Vetëqeverisjes Vendore, APP-në dhe KPP-në.

5.02 Afati për hyrjen në fuqi është data 120 (njëqind e njëzet) pas datës së nënshkrimit.

Neni VI

Përfaqësuesi; adresat

6.01 Përfaqësuesi i Huamarrësit është ministri i Financave.

6.02 Për qëllimet e seksionit 10.01 të kushteve të përgjithshme:

a) Adresa e Huamarrësit është:
Ministria e Financave
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3
Tiranë, Shqipëri; dhe
b) Adresa elektronike e Huamarrësit është:
E-mail:
sekretariamin@financa.gov.al

6.03 Për qëllimet e seksionit 10.01 të kushteve të përgjithshme:

a) Adresa e Bankës është:
Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim
1818 H Street, N.W.
Washington, D.C. 20433
United States of America (Shtetet e Bashkuara të Amerikës); dhe
b) Adresa elektronike e Bankës është:
Teleks: Faks:
248423 (MCI) ose 1-202-477-6391
64145 (MCI)

RËNË DAKORD që nga data e nënshkrimit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nga
Përfaqësuesi i autorizuar
Emri: PETRIT MALAJ
Funksioni: Ministër i Financave
Data: 22 prill 2025

BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Nga
Përfaqësuesi i autorizuar
Emri: XIAO GING YU
Funksioni: Drejtor i Divizionit, Ballkani Perëndimor
Data: 9 prill 2025

SKEDULI 1 Përshkrimi i Veprimit

Qëllimi i Veprimit është të rritet aksesimi i barabartë dhe cilësia e shërbimeve digjitale të përzgjedhura.

Veprimi përbëhet nga fushat shtesë të rezultateve 3.3, 3.4, 3.5, 3.6 dhe 4 sipas pjesës 1 (Programi) dhe pjesës 2 (Projekti) të Veprimit Fillestar, siç është ndryshuar këtu (fushat shtesë të rezultateve dhe modifikimet janë paraqitur me shkronja të pjerrëta):

Pjesa 1: Programi

Programi përbëhet nga aktivitetet e mëposhtme sipas Programit të Transformimit Digjital të Huamarrësit dhe pasuesi i tij:

Fusha e rezultateve 3: Forcimi i mundësive të ofrimit të shërbimeve prioritare

Mbështetje për: (a) forcimin e qeverisjes së të dhënave, sigurisë dhe transparencës së të dhënave; (b) adoptimin e sistemeve, kërkesave dhe proceseve inteligjente digjitale mundësuese; (c) *modernizimin e sistemit të prokurimit elektronik; dhe (d) përmirësimin dhe zgjerimin e Sistemit të Informacionit të Menaxhimit Financiar Shqiptar (AFMIS) nëpërmjet:*

3.3 Përgatitjes së procedurave dhe të dhënave për Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe aplikimet e LA-së përmes: (a) thjeshtimit të procedurave të prokurimit që do të zbatohen në Sistemin e Prokurimit Elektronik; (b) vendosjen e procedurave për raportimin e të dhënave të prokurimit në portalin ditor elektronik të tenderave (TED), duke përdorur standardin e

formularit elektronik të përsërkruar; (c) përcaktimin dhe detajimin e kërkesave për integrimin e Sistemit të Prokurimit elektronik me sistemet e jashtme të TIK-ut; dhe (d) dizajnimin/projektimin e sistemit të katalogut elektronik për zhvillimin e sistemit dinamik të blerjes/ ankandit elektronik;

3.4 Zhvillimit dhe zbatimit të Sistemit të Prokurimit Elektronik të Mundësuar nga Inteligenca Artificiale (IA), si dhe shtrirja e plotë e tij; dhe

3.5 Kryerjes së reformave qendrore të PFM-së/PIM-it dhe zgjerimit të SIMF-it / AFMIS-it qendror nëpërmjet: (a) kryerjes së një vlerësimi diagnostikues për të identifikuar nevojat e integritit në modulet kryesore të softuerit; (b) zbatimit të përmirësimeve të harduerit për të përmirësuar besueshmërinë, sigurinë dhe shkallëzueshmërinë e sistemit; (c) prioritizimit të integritit të sistemit me Sistemin e Informacionit Financiar të Qeverisë Shqiptare dhe Sistemin e Informacionit të Sistemit të Planifikimit të Integruar për të harmonizuar funksionet e planifikimit, buxhetimit dhe raportimit; (d) zhvillimit të programeve të synuara të trajnimit SIMF/AFMIS për ministrinë e linjës dhe QL-të; (e) rishikimit të strategjive të personelit dhe burimeve për të siguruar personel të përshtatshëm për rolet financiare të qeverisë qendrore; (f) zgjerimit të rregullores aktuale të PIM-it të nivelit të qeverisë qendrore për qeveritë nënkombëtare, së bashku me rishikimin dhe riorganizimin e linjës së vetme të projektit (SPP); dhe (g) integritit të një mjeti për shqyrtimin e rrezikut të klimës për të përfshirë elasticitetin klimatik në proceset PIM nga planifikimi deri në fazat e vlerësimit.

3.6 Kryerjes së reformave lokale të PFM-së/PIM-it dhe zgjerimit të SIMF-it / AFMIS-it të QL-të për të shtrirë funksionalitetin e SIMF-it/AFMIS-it të qeverisjet vendore (QL) nëpërmjet: (a) kryerjes së një vlerësimi diagnostikues të proceseve të MFP QK; (b) mbledhjes së kërkesave funksionale për të garantuar përputhshmërinë e AFMIS-it me veprimet e QL-së dhe për të vlerësuar nevojat e pajisjeve dhe infrastrukturës së rrjetit në të gjitha QL-të; (c) zhvillimit të dizajnit teknik për të përmbushur këto kërkesa; (d) fillimit të një zbatimi pilot në QL-të e zgjedhura, duke përfshirë përmirësime të përsëritura bazuar në reagimet e përdoruesve; (e) zhvillimit të iniciativave për ngritjen e kapaciteteve dhe ndryshimin e menaxhimit për të përgatitur personelin e QL-së për miratimin e SIMF-it/AFMIS-it; (f) zgjerimit të shtrirjes së AFMIS-it në të gjitha QL-të për modulet prioritare dhe zhvillimin e modulit shtesë.

Fusha e rezultateve 4: Rritja e aksesit, cilësia dhe efikasiteti i shërbimeve të zgjedhura administrative lokale

Mbështetje për të përmirësuar aksesin dhe cilësinë e shërbimeve të zgjedhura lokale përmes:

4.1 Riinxhinierimit të shërbimeve administrative vendore me fokus përdoruesin dhe integrimin në e-Albania 2.0 nëpërmjet: (a) riinxhinierimit dhe ridizajnit/riprojektimit me fokus përdoruesin e deri në 15 shërbime të përzgjedhura prioritare të QL-së për të përfshirë të gjitha pjesët e shërbimit të zbatuara nëpërmjet e-Albania, si dhe shërbime të tjera të pavarura; (b) riinxhinierimit dhe automatizimit të shërbimeve të përzgjedhura të QL-së që lidhen me zbutjen dhe/ose përshtatjen klimatike; (c) automatizimit të shërbimeve të QL-së, gjithashtu në përputhje me Standardet e reja të Shërbimit Digjital dhe zbatimit në e-Albania 2.0; (d) aty ku është e përshtatshme dhe e realizueshme, duke integruar shërbimet e përzgjedhura të QL-së në logjikën LE; (e) përmirësimit të qeverisjes së të dhënave të QL-së nëpërmjet aplikimit të kuadrit të ri të ndërveprimit në Shqipëri nga QL-të; dhe (f) përpunimit të një strategjie vendore të fuqisë punëtore dhe burimeve njerëzore për të përmirësuar kapacitetin e QL-së për të trajtuar riinxhinierimin dhe digjitalizimin e shërbimeve administrative lokale, si dhe për të përmirësuar kapacitetin e QL-së për të integruar dimensionet e zbutjes dhe përshtatjes klimatike në shërbimin administrativ.

4.2 Përmirësimit të shërbimit ndaj klientit, përfshirjes dhe aksesueshmërisë për të mbështetur shërbimin e përmirësuar të klientit dhe për të garantuar akses të përmirësuar në shërbimet e përzgjedhura të QL-së përmes: (a) integritit të sistemeve, proceseve dhe shërbimeve të QL-së në Qendrën e Kontaktit Gjithëpërfshirës (OCCC); (b) konvertimit të zyrave kryesore të përzgjedhura të QL-së në qendrat e inovacionit rinor (YIC); dhe (c) mbështetjes së aktiviteteve të përzgjedhura për të përmirësuar aksesin në shërbim për grupet e cënueshme;

4.3 Përmirësimit të sektorit kryesor publik dhe mundësuesve digjitalë të ofrimit të shërbimeve QL për t'u mundësuar QL-ve që të përmirësojnë ofrimin e shërbimeve të tyre nëpërmjet (a) vendosjes së standardeve teknike për investimet në softuer dhe harduer për të mundësuar ofrimin e shërbimit digjital të QL-së dhe integrimin e QL-së në platformën ekzistuese të ndërveprueshmërisë qeveritare; (b) krijimit të një infrastrukture TIK dhe platformës qendrore harduer; (c) integritit të shërbimeve elektronike të pranueshme QL dhe regjistrave të digjitalizuar me GIP (Government Gateway dhe SQDNE), me qëllim krijimin e shërbimeve elektronike të përqendruara të përdoruesit; dhe (d) integrimin e inteligjencës artificiale (AI) brenda cloud (hapësirës së ruajtjes në internet) të QL-së, për të mundësuar modelimin e IA-së në shërbimet elektronike të QL-së dhe për të lehtësuar integrimin e asistentit virtual të Shqipërisë në shërbimet e pranueshme të QL-së të disponueshme përmes e-Albania dhe OCCC.

Pjesa 2: Projekti

Projekti përbëhet nga aktivitetet e mëposhtme për të ndihmuar në zbatimin e Programit:

- a) ofrimin e mbështetjes teknike në fushat e përzgjedhura të rezultateve të Programit, duke përfshirë ndër të tjera kontributet e ekspertëve për hartimin e specifikimeve teknike;
- b) ngritjen e kapaciteteve dhe trajnimin për të mundësuar zbatimin dhe pranimin e reformave të Programit;
- c) hartimin dhe zbatimin e një strategjie të menaxhimit të ndryshimit për QL-në; dhe
- d) mbështetjen e zbatimit dhe monitorimin dhe vlerësimin, duke përfshirë kostot e trajnimit dhe kostot operative për Njësinë e Koordinimit për menaxhimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e veprimit, duke përfshirë kostot për agjentët e pavarur të verifikimit.

SKEDULI 2

Ekzekutimi i Programit

Seksioni I. Masat e zbatimit

A. Institucionet e Programit

1. Huamarrësi, nëpërmjet AKSHI-t, do të mbajë gjatë gjithë zbatimit të Veprimit, një komitet drejtues (“Komiteti Drejtues”): (a) me përbërje, mandat dhe burime të pranueshme për Bankën; (b) të kryesuar nga Kryeministri; (c) të përbërë, ndër të tjera, nga përfaqësues të MF, SASPAC-ut, AKSHI-t, MSLG-së, APP-së, KPP-së dhe ministrive të tjera përkatëse të Huamarrësit dhe agjencive qeveritare; dhe (d) përgjegjës, ndër të tjera, për koordinimin ndërinstitucional të nivelit të lartë dhe funksionet e përgjithshme të zbatimit strategjik, të gjitha të përshkruara më tej në Manualin Operacional.

2. Për të lehtësuar kryerjen e aktiviteteve sipas fushave të rezultateve 3.3, 3.4, 3.5, 3.6 dhe 4 nën pjesën 1 të Veprimit, Huamarrësi, nëpërmjet AKSHI-t, krijon, jo më vonë se 3 (tre) muaj nga data e hyrjes në fuqi, tri grupe pune ndërinstitucionale për: (a) prokurimin (“Grupi i Punës për Prokurimin”), (b) AFMIS-in (“Grupi i Punës i AFMIS-it”); dhe (c) për aktivitetet e digjitalizimit të QL-ve (“Grupi i Punës i Digjitalizimit të QL-ve”): (i) me përbërje, mandat dhe burime të pranueshme për Bankën; (ii) të përbërë, ndër të tjera, nga përfaqësues të nivelit të lartë të ministrive përkatëse; dhe (iii) përgjegjës, ndër të tjera, për të mbikëqyrur zbatimin e Veprimit në nivel teknik dhe për të raportuar mbi progresin te Komiteti Drejtues, të gjitha të përshkruara më tej në Manualin Operacional.

3. Huamarrësi, nëpërmjet AKSHI-t: (a) do të jetë përgjegjës për zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e përgjithshëm të Veprimit; dhe (b) do të mbajë, gjatë gjithë zbatimit të Veprimit, një Njësi Koordinimi (“Njësia e Koordinimit”) përgjegjëse për monitorimin e Veprimit, me përbërje, funksione, personel, lehtësira dhe burime të tjera të pranueshme për Bankën dhe siç përshkruhet më tej në Manualin Operacional.

4. Për të lehtësuar kryerjen e aktiviteteve në kuadër të Veprimit, Huamarrësi, nëpërmjet AKSHI-t:

a) do të caktojë, në çdo kohë gjatë zbatimit të Veprimit, MF-në, MSLG-në, Agjencinë e Vetëqeverisjes Vendore, QL-të pjesëmarrëse, APP-në dhe KPP-në që të jenë përgjegjëse për ofrimin e mbështetjes teknike për AKSHI-n dhe grupet ndërinstitucionale të punës, në arritjen e DLI-ve/DLR-ve të tyre përkatëse, siç përcaktohet në Planin e Veprimit të Programit dhe Manualin Operacional;

b) do të marrë masa që MF-ja, MSLG-ja, Agjencia për Vetëqeverisjen Lokale, APP-ja dhe KPP-ja të lidhin një marrëveshje (“Memorandum Mirëkuptimi”) me terma dhe kushte të pranueshme për Bankën, në mënyrë që të mbrojnë interesat e Huamarrësit dhe Bankës dhe të realizojnë qëllimet e Veprimit, i cili do të përfshijë, ndër të tjera, kushtet e angazhimit të MF-së, AKSHI-t, MSLG-së, Agjencisë për Vetëqeverisje Lokale, APP-së dhe KPP-së, detyrimet e raportimit dhe do të specifikojnë ndarjen e përgjegjësisë dhe rolet e tyre përkatëse në zbatimin e pjesëve të tyre përkatëse të Veprimit. Me përjashtim të rasteve kur Banka bie dakord ndryshe, MF-ja, AKSHI, MSLG-ja, Agjencia e Vetëqeverisjes Lokale, APP-ja dhe KPP-ja nuk do të caktojnë, ndryshojnë, shfuqizojnë ose heqin dorë, ose nuk do të lejojnë caktimin, ndryshimin, shfuqizimin, ose heqjen dorë nga sa më sipër, ose ndonjë dispozitë të saj.

B. Masat shitesë për zbatimin e Programit

1. Plani i Veprimit të Programit

Pa kufizim në përgjithësinë e pjesës A të këtij seksioni I, Huamarrësi, nëpërmjet AKSHI-t:

a) do të zbatojë Planin e Veprimit të Programit, ose do të marrë masa që Plani i Veprimit të Programit të zbatohet, në përputhje me skedulën e përcaktuar në Planin e Veprimit të Programit në fjalë, në një mënyrë të kënaqshme për Bankën;

b) me përjashtim të rasteve kur Banka bie dakord ndryshe me shkrim, nuk cakton, ndryshon, shfuqizon ose heq dorë, ose nuk lejon të caktohet, ndryshohet, shfuqizohet ose hiqet dorë nga ndonjë detyrim dhe/ose përgjegjësi e përcaktuar në Planin e Veprimit të Programit, ose ndonjë dispozitë të saj; dhe

c) do të mbajë politika dhe procedura të përshtatshme për t'i mundësuar që të monitorojë dhe vlerësojë, në një mënyrë dhe përmbajtje të kënaqshme për Bankën, detyrimet/angazhimet e tij sipas Planit të Veprimit të Programit.

2. Mekanizmi i pavarur i verifikimit

Huamarrësi, nëpërmjet AKSHI-t:

a) do të emërojë dhe më pas do të mbajë, në çdo kohë gjatë zbatimit të Programit, agentë të pavarur verifikimi sipas kushteve të referencës të pranueshme për Bankën ("agentët e pavarur të verifikimit"), për të verifikuar të dhënat dhe provat e tjera që mbështesin arritjen e një ose më shumë DLI-ve/DLR-ve të përcaktuara në tabelën në seksionin IV.A.2. të këtij skeduli 2 dhe do të rekomandojnë kryerjen e pagesave përkatëse, sipas rastit;

b) (i) do të sigurojë që agentët e pavarur të verifikimit të kryejnë verifikimin dhe proceset në përputhje me protokollin e verifikimit; dhe (ii) do t'i dorëzojë Bankës raportet përkatëse të verifikimit në kohën e duhur dhe në formë dhe përmbajtje të kënaqshme për Bankën; dhe

c) në rast se ka nevojë për shërbime verifikimi përpara emërimit të Agjentëve të Pavarur të Verifikimit në përputhje me nënparagrafin "a" më sipër, do të bëjë funksionale një masë të përkohshme të përshtatshme, të kënaqshme për Bankën dhe të miratuar me shkrim nga Banka për verifikimin e DLI-ve/DLR-ve.

C. Manuali operacional

1. Huamarrësi, nëpërmjet AKSHI-t, jo më vonë se 1 (një) muaj pas datës së hyrjes në fuqi, do të përditësojë Manualin Operacional në përmbajtje dhe mënyrë të pranueshme për Bankën.

2. Huamarrësi, nëpërmjet AKSHI-t, mban dhe kryen Veprimin në përputhje me Manualin Operacional që përcakton udhëzimet dhe procedurat e detajuara institucionale, administrative, financiare, teknike dhe operacionale për zbatimin e Programit, Projektit, Planit të Veprimit të Programit dhe duke përfshirë, ndër të tjera: (a) një përshkrim të detajuar të kuadrit të shpenzimeve të Programit; (b) DLI-të/DLR-të, standardet referuese dhe formulat e disbursimit të tyre, dhe protokollet e verifikimit; (c) një sistem monitorimi dhe verifikimi për Programin; (d) masat mbrojtëse të detajuara, menaxhimin financiar (duke përfshirë qarkullimin e fondeve dhe buxhetimin) dhe masat e prokurimit; dhe (e) marrëveshjet e zbatimit, përfshirë rolet e grupeve të ndryshme të interesit, procesin e vendimmarrjes dhe përgjegjësitë e personelit të Njësisë së Koordinimit, marrëveshjet brenda dhe ndër-institucionale të Programit, duke përfshirë caktimin e roleve dhe përgjegjësi të QL-ve pjesëmarrëse; (f) masat e prokurimit për Programin, ndarjen e qartë të përgjegjësi të prokurimit sipas tij, përfshirë sistemet e mbajtjes së të dhënave dhe mekanizmat e parandalimit dhe raportimit të korrupsionit; (g) protokollet për raportimin të Banka dhe ndarjen e rezultateve të çdo rasti mashtrimi dhe korrupsioni të denoncuar dhe/ose hetuar në kuadër të Programit, në përputhje me udhëzimet antikorrupsion.

3. Huamarrësi, nëpërmjet AKSHI-t, nuk do të ndryshojë, shfuqizojë ose pezullojë, ose nuk do të lejojë që të ndryshohet, shfuqizohet ose pezullohet asnjë dispozitë e Manualit Operacional, pa miratimin paraprak me shkrim të Bankës.

4. Pavarësisht nga sa më sipër, nëse ndonjë dispozitë e Manualit Operacional nuk është në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të kenë përparësi.

D. Masat mjedisore dhe sociale për Projektin

1. Huamarrësi do të sigurojë dhe do të marrë masa që AKSHI të sigurojë që Projekti të kryhet në përputhje me Standardet Mjedisore dhe Sociale, në një mënyrë të pranueshme për Bankën.

2. Pa kufizim në paragrafin 1 më sipër, Huamarrësi do të marrë masa që AKSHI të sigurojë që Projekti të zbatohet në përputhje me Planin e Angazhimit Mjedor dhe Social ("PSSM"), në një mënyrë të pranueshme për Bankën. Për këtë qëllim, Huamarrësi do të sigurojë dhe do të marrë masa që AKSHI të garantojë që:

a) masat dhe veprimet e specifikuar në PSSM të zbatohen me kujdesin dhe efikasitetin e duhur, siç parashikohet në PSSM;

b) janë në dispozicion fonde të mjaftueshme për të mbuluar kostot e zbatimit të PSSM-së;

c) politikat dhe procedurat të mbahen dhe personeli i kualifikuar dhe me përvojë, në numër të mjaftueshëm, të mbahet për zbatimin e PSSM-së, siç parashikohet në PSSM; dhe

d) PSSM-ja, ose ndonjë dispozitë e tij nuk ndryshohet, shfuqizohet, pezullohet ose hiqet dorë, përveç nëse Banka bie dakord ndryshe me shkrim, siç specifikohet në PSSM, dhe siguron që PSSM-ja e rishikuar të zbulohet menjëherë më pas.

3. Në rast të ndonjë mospërputhjeje ndërmjet PSSM-së dhe dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të kenë përparësi.

4. Huamarrësi do të marrë masa që AKSHI të garantojë, se:

a) janë marrë të gjitha masat e nevojshme për të mbledhur, përpiluar dhe për t'i dhënë Bankës nëpërmjet raporteve të rregullta, me shpeshtësinë e specifikuar në PSSM, dhe menjëherë në një raport ose raporte të veçanta, nëse kërkohet nga Banka, informacion mbi statusin e përputhshmërisë me PSSM-në dhe instrumentet mjedisore dhe sociale të përmendura në të, të gjitha raportet e tilla në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën, duke përcaktuar, ndër të tjera: (i) statusin e zbatimit të PSSM-së; (ii) kushtet, nëse ka, të cilat ndërhyjnë ose rrezikojnë të ndërhyjnë në zbatimin e PSSM-së; dhe (iii) masat korrigjuese dhe parandaluese të marra ose që kërkohen të merren për të trajtuar këto kushte; dhe

b) Banka njoftohet menjëherë për çdo incident ose aksident që lidhet ose ka ndikim në projekt, i cili ka ose mund të ketë efekt negativ të konsiderueshëm në mjedis, komunitetet e prekura, publikun ose punëtorët, në përputhje me PSSM-në, instrumentet mjedisore dhe sociale të referuara aty dhe Standardet Mjedisore dhe Sociale.

5. Huamarrësi do të marrë masa që AKSHI të krijojë, publikojë, mbajë dhe operojë një mekanizëm të aksesueshëm ankesash, për të marrë dhe lehtësuar zgjidhjen e problemeve dhe ankesave të personave të prekur nga Projekti dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme dhe të duhura për të zgjidhur ose lehtësuar zgjidhjen e problemeve dhe ankesave të tilla, në një mënyrë të pranueshme për Bankën.

6. Huamarrësi, nëpërmjet AKSHI-t, do të përgatisë, miratojë, mbajë dhe operojë mekanizmin e ankesave të Projektit, jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas datës së hyrjes në fuqi.

Seksioni II. Aktivitetet e përjashtuara

Huamarrësi, nëpërmjet AKSHI-t, siguron që Programi të përjashtojë çdo aktivitet që:

A. sipas opinionit të Bankës, mund të kenë ndikime të konsiderueshme negative që janë sensitive, të ndryshme ose të paprecedentë në mjedis dhe/ose personat e prekur; ose

B. përfshijnë prokurimin e: (1) punëve që vlerësohet të kushtojnë 75 milionë USD (dollarë amerikanë) ose më shumë për kontratë; (2) mallrave që vlerësohet të kushtojnë 50 milionë USD (dollarë amerikanë) ekuivalentë ose më shumë për kontratë; (3) shërbimeve jokonsulente që vlerësohet të kushtojnë 50 milionë USD (dollarë amerikanë) ose më shumë për kontratë; ose (4) shërbimeve konsulente që vlerësohet të kushtojnë 20 milionë USD (dollarë amerikanë) ekuivalentë ose më shumë për kontratë.

Seksioni III. Monitorimi, raportimi dhe vlerësimi i Veprimit

1. Huamarrësi, nëpërmjet AKSHI-t, do t'i dorëzojë Bankës çdo raport veprimi jo më vonë se 45 (dyzet e pesë) ditë pas përfundimit të çdo semestri (gjashtëmujori) kalendarik, duke mbuluar semestrin kalendarik.

2. Pa kufizim në dispozitën e seksionit 5.13 të kushteve të përgjithshme për Programin, Huamarrësi nëpërmjet AKSHI-së dhe në përputhje me rregullimet dhe mekanizmat institucionalë të përcaktuar në POM dhe PAP, do të përgatisë dhe të japë ose të bëjë që të përgatiten dhe të dorëzohen raportet periodike të ACG-së, në formë dhe përmbajtje të kënaqshme për Bankën jo më vonë se 45 (dyzet e pesë) ditë pas përfundimit të çdo semestri kalendarik, duke mbuluar semestrin kalendarik.

Seksioni IV. Tërheqja e të ardhurave të Huas

A. Të përgjithshme

1. Pa kufizim në dispozitat e nenit II të kushteve të përgjithshme dhe në përputhje me letrën e disbursimit dhe informacionit financiar, Huamarrësi mund të tërheqë të ardhurat e Huas: (a) në lidhje me Programin, financimin e shpenzimeve të Programit (përfshirë taksat), në bazë të rezultateve ("Rezultatet e lidhura me disbursimin" ose "DLR-të") të arritura nga Huamarrësi, të matura kundrejt treguesve specifikë ("Treguesit e lidhur me disbursimin" ose "DLI-të"); (b) në lidhje me Projektin, të financojë shpenzimet e pranueshme në shumën e alokuar dhe, nëse është e zbatueshme, deri në përqindjen e caktuar kundrejt kategorisë 3; dhe (c) të paguajë: (i) tarifat paraprake; dhe (ii) të paguajë çdo

kufi norme interesi ose prim të instrumentit mbrojtës të normës së interesit; të gjitha siç janë përcaktuar në tabelën në paragrafin 2 të kësaj pjese A.

2. Tabela e mëposhtme specifikon çdo kategori të tërheqjes së të ardhurave të Huas (duke përfshirë treguesit e lidhur me disbursimin, sipas rastit) ("Kategoria"), rezultatet e lidhura me disbursimin për secilën kategori (sipas rastit) dhe alokimin e shumave të Huas për secilën kategori:

Kategoria (duke përfshirë treguesin e lidhur me disbursimin, siç është e zbatueshme)	Rezultati i lidhur me disbursimin (siç është e zbatueshme)	Formula e disbursimit	Shuma e Huas së alokuar (e shprehur në EURO)	Përqindja e shpenzimeve që do të financohen (përfshirë taksat)
(1) DLI #8: Forcimi i mundësive kryesore të ofrimit të shërbimeve publike	DLR #8.1: (i) ToR e platformës së prokurimit elektronik, i informuar nga kërkimi i përdoruesit, i miratuar nga GP e Prokurimit dhe (ii) kontratën e nënshkruar për platformën e prokurimit elektronik.	(i) ToR = 3,225,000 EUR; (ii) Kontrata e nënshkruar për platformën e prokurimit elektronik = 3,225,000 EUR	6,450,000	E pazbatueshme
	DLR #8.2: (i) ToR e përmirësimit dhe zgjerimit të AFMIS të miratuar nga GP AFMIS, dhe (ii) përmirësimi dhe zgjerimi i kontratës së nënshkruar AFMIS	(i) ToR = 1,900,000 EUR; (ii) përmirësimi dhe zgjerimi i kontratës së nënshkruar AFMIS = 1,900,000	3,800,000	E pazbatueshme
	DLR #8.3: Platforma e prokurimit elektronik është e testuar nga përdoruesit dhe funksionale me funksione prioritare, duke përfshirë etiketimin e gjelbër të prokurimit	çdo funksionalitet = 1,520,000 EUR	7,600,000	E pazbatueshme
	DLR #8.4: 50% e QL-ve pjesëmarrëse kryejnë proceset e tyre të PFM-së (përfshirë kontrollin e rrezikut klimatik të investimeve publike) përmes AFMIS-it lokal	Çdo % = 76,000 EUR	3,800,000	E pazbatueshme
	DLR # 8.5: Sistemi i prokurimit elektronik po përdor AI në faza të zgjedhura të procesit të prokurimit publik	E pazbatueshme	5 700 000	E pazbatueshme
(2) DLI #9: Rënxhinierimi dhe digjitalizimi i Shërbimeve të Pushtetit Vendor	DLR #9.1: Lista e shërbimeve prioritare të QL-ve për digjitalizim, duke përfshirë shërbimet e QL-ve që lidhen me CC-në, të miratuar nga GP i Digjitalizimit të QL-ve	E pazbatueshme	8,500,000	E pazbatueshme
	DLR #9.2: Plani i fuqisë punëtore të LG për ofrimin e shërbimeve dhe nevojat e lidhura me TIK, miratuar nga LG për Digjitalizimin e QL-ve	E pazbatueshme	6,450,000	E pazbatueshme
	DLR #9.3: 50% LG përdorin infrastrukturë të re/zgjeruar digjitale e cila redukton përdorimin e letres dhe emetimet GHG dhe përfshin takimin e harduerit ENERGY STAR	secila % = 304,000 EUR	15,200,000	E pazbatueshme
	DLR #9.4: 8 shërbime	çdo shërbim QL-je =	9,500,000	E pazbatueshme

	prioritare LG dhe 2 shërbime LG të fokusuara në CC janë riinxhinieruar dhe zbatuar në e-Albania 2.0	950,000 EURO		
	<u>DLR #9.5: 22% rritje në përdorimin e shërbimeve të aktivizuara në mënyrë digjitale , duke përfshirë shërbimet e fokusuara në CC bazuar në numrin e regjistruar të aplikacioneve</u>	Çdo% = 259,091	5,700,000	
(3) Mallrat, shërbimet jokonsulente, këshillimi, trajnimi dhe kostot operative në rritje sipas pjesës 2 të Projektit			4,007,750	100%
(4) Tarifa paraprake që duhet paguar në përputhje me seksionin 2.03 të kësaj Marrëveshjeje në përputhje me seksionin 2.05(b) të kushteve të përgjithshme			192,250	
(5) Kufiri i normës së interesit ose primi i instrumentit mbrojtës të normës së interesit që duhet paguar në përputhje me seksionin 4.05 (c) të kushteve të përgjithshme			0	
SHUMA TOTALE			76,900,000	

B. Kushtet e tërheqjes; periodha e tërheqjes

1. Pavarësisht nga dispozitat e pjesës A të këtij seksioni, asnjë tërheqje nuk do të bëhet:

a) në bazë të DLR-ve të arritura përpara datës së nënshkrimit, përveç që tërheqjet deri në një shumë totale që nuk tejkalon tetë milionë e pesëqind mijë euro (8,500,000 euro) mund të bëhen në bazë të DLR #9.1 të arritur para kësaj date por më ose pas 26 dhjetor 2024; ose

b) për çdo DLR sipas kategorisë 1 ose 2 derisa dhe nëse Huamarrësi nuk i ka dhënë Bankës prova të kënaqshme që DLR-ja në fjalë është arritur.

2. Pavarësisht nga dispozitat e pjesës B.1(b) të këtij seksioni, Huamarrësi mund të tërheqë: një shumë që nuk duhet të kalojë trembëdhjetë milionë euro (13,000,000 euro) si paradhënie; megjithatë, me kusht që nëse DLR-të, sipas mendimit të Bankës, nuk arrihen deri në datën e mbylljes, Huamarrësi do ta rimbursojë këtë paradhënie në Bankë menjëherë pas njoftimit nga Banka. Përveç rasteve kur është rënë dakord ndryshe me Huamarrësin, Banka do të anulojë shumën e rimbursuar në këtë mënyrë. Çdo tërheqje e mëtejshme e kërkuar si paradhënie sipas çdo kategorie do të lejohet vetëm me terma dhe kushte që Banka do të specifikojë me njoftimin e Huamarrësit.

3. Pavarësisht nga dispozitat e pjesës B.1(b) të këtij seksioni, nëse ndonjë nga DLR-të sipas kategorisë 1 ose 2 nuk është arritur deri në datën kur DLR-ja në fjalë është caktuar të arrihet (ose në atë datë të mëvonshme që Banka ka caktuar me njoftim për Huamarrësin), Banka, duke njoftuar Huamarrësin, mund: (a) të autorizojë tërheqjen e një shume më të vogël të të ardhurave të patërhequra të Huas të alokuara më pas në kategorinë në fjalë, e cila, sipas opinionit të Bankës, korrespondon me masën e arritjes së DLR-së në fjalë, shuma më e vogël në fjalë do të llogaritet në përputhje me formulën e përcaktuar në paragrafin IV.A.2 të këtij seksioni IV; (b) të rialokojë të gjitha ose një pjesë të të ardhurave të Huas, të alokuara më pas për DLR-në në fjalë, te ndonjë DLR tjetër; dhe/ose (c) të anulojë të gjitha ose një pjesë të të ardhurave të Huas që më pas i alokohen DLR-së në fjalë.

4. Data e mbylljes është 31 maj 2029.

SKEDULI 3

Skeduli i shlyerjes së amortizimit të lidhur me angazhimin

Tabela e mëposhtme cakton datat e pagesës së principalit të Huas dhe përqindjen e shumës totale të principalit të Huas që paguhet në secilën datë të pagesës së principalit (“Aksioni me këste”).

Shlyrjet e principalit të nivelit

Data e pagesës së principalit	Aksioni me këste
Në çdo 1 mars dhe 1 shtator Duke filluar nga 1 shtatori 2030 deri më 1 shtator 2042	_____3.85%
Më 1 mars 2043	_____3.75%

SHTOJCË

Përkufizime

1. “Agjencia për Qeverisjen Vendore” ose “ALG” nënkupton agjencinë e Huamarrësit përgjegjëse për qeveritë vendore e krijuar në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 227 të Huamarrësit, datë 9 prill 2024 ose çdo pasardhës të tij.

2. “Sistem i Informacionit Financiar të Qeverisë së Shqipërisë” ose “AGFIS” nënkupton sistemin qendror të TIK-ut që menaxhohet nga Ministria e Financave dhe përdoret për ekzekutimin e buxhetit në Qeverinë e Shqipërisë.

3. AVA

4. “Raport ACG-je” nënkupton raportin periodik të Huamarrësit që do të përgatitet nga AKSHI, në përputhje me këtë Marrëveshje dhe me dispozitat e udhëzimeve antikorrupsion, duke përfshirë nëse ka pasur apo jo: (a) ndonjë pretendim të besueshëm dhe material dhe tregues të tjerë të mashtrimit dhe korrupsionit sipas Programit, të cilat i sillen në vëmendje institucioneve përkatëse të Huamarrësit gjatë kësaj periudhe; (b) çdo hetim të nisur nga institucionet përkatëse të Huamarrësit për pretendime të tilla, progresin dhe rezultatet e tyre; dhe (c) çdo veprim përmirësues ose korrigjues të ndërmarrë ose të planifikuar në përgjigje të një pretendimi të tillë ose rezultateve të këtyre hetimeve.

5. “Sistem i Informacionit të Menaxhimit Financiar të Shqipërisë” ose “AFMIS” nënkupton sistemin parësor të informacionit të menaxhimit financiar të Huamarrësit për institucionet buxhetore të qeverisë qendrore në Shqipëri.

6. “GP i AFMIS-it” nënkupton një grup pune ndërinstitucional të krijuar në përputhje me seksionin I.A.2 në skedulin 2 të kësaj Marrëveshjeje, të përbërë nga përfaqësues të MF-së MSLG-së, Agjencisë për Pushtetin Vendor (ALG), QL-ve të përzgjedhur dhe AKSHI-t, me qëllim: (i) hartimin e termave të referencës për prokurimin AFMIS në kuadër të programit; (ii) mbikëqyr zbatimin e investimeve të programit AFMIS; dhe (iii) të sigurojë arritjen e rezultateve të programit të lidhura me AFMIS-in.

7. “IA” nënkupton inteligjencën artificiale.

8. “AKSHI” nënkupton agjencinë kombëtare të Huamarrësit për shoqërinë e informacionit (AKSHI), të krijuar në varësi të Kryeministrit, në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 673, datë 22 nëntor 2017, të ndryshuar, ose ndonjë pasues të saj të pranueshëm për Bankën, ose ndonjë pasues të saj.

9. “Legjislacion i AKSHI-t” nënkupton vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 673, datë 22.11.2017, të ndryshuar.

10. “Udhëzime antikorrupsion” nënkupton: (a) për qëllimet e paragrafit 6 të shtojcës së kushteve të përgjithshme të Programit, “Udhëzimet e Bankës për parandalimin dhe luftimin e mashtrimit dhe korrupsionit në financimin e programit për rezultatet” të Bankës, datë 1 shkurt 2012 dhe të rishikuar më 10 korrik 2015; dhe (b) për qëllimet e paragrafit 6 të shtojcës së kushteve të përgjithshme të Projektit, “Udhëzimet për parandalimin dhe luftimin e mashtrimit dhe korrupsionit në projektet e financuara nga huat e BERZH-it dhe kreditë dhe grantet e IDA-s”, datë 15 tetor 2006 dhe të rishikuar në janar 2011 dhe nga 1 korriku 2016.

11. “Kategori” nënkupton një kategori të përcaktuar në tabelën në seksionin IV.A.2 të skedulit 2 të kësaj Marrëveshjeje.

12. “Njësia e Koordinimit” nënkupton njësinë e krijuar në përputhje me seksionin 5.01(b) të Marrëveshjes origjinale të Huas dhe e përmendur më tej në seksionin I.A.3 në shtojcën 2 të kësaj Marrëveshjeje e përbërë, ndër të tjera, nga një drejtor programi, menaxher programi, specialist i prokurimit, financiar specialist menaxhimi, specialist monitorimi dhe vlerësimi, specialist i teknologjisë së arsimit.

13. “Program Transformimi Digjital” nënkupton Strategjinë Kombëtare të Huamarrësit për Zhvillim dhe Integrim Evropian (SKZHIE) (2022–2030), Strategjinë dhe Planin e Veprimit Digjital të Shqipërisë 2022–2026, Strategjinë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore (2023–2030), ligjin

